



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parshtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 72-të, të mbajtur më 29.07.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Procedura sipas llëndës me numër 09-3855/1, është formuar sipas denoncimit të dorëzuar nga një parashtrues i panjohur kundër personit zyrtarë -----, udhëheqës i njësisë së -----inspektor i lartë -----i punësuar në inistrinë e ----- NDËRPRITET.

KSHPK konstatoi se pretendimet nga dneoncimi vërtetohen, por ka ndrzshime në gjendjen faktike, pas së cilës KSHPK-ja nuk ka elemente për veprim kompetent.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 09-3855/1 të datës 11.11.2020 është formuar pas denoncimit të dorëzuar nga një parashtrues i panjohur kundër personit zyrtarë -----udhëheqës i njësisë së -----Inspektor i lartë në -----, e punësuar në Ministrinë e -----me pretendime se e njëjta ka kryer mbikqyrje inspektuese mbi punën e Komisionit për Licencimin e Profesionistëve në Sistemin e Kujdesit dhe Edukimit të Fëmijëve Parashkollor dhe Drejtorëve të Institucioneve të Fëmijëve dhe ku i njëjti është anëtar i atij Komisioni.

Në drejtim të përcaktimit të gjendjes faktike në rastin konkret dhe përcaktimin e pretendimeve nga denoncimi, KSHPK kërkoi të dhëna dhe dokumentacione nga Ministria e -----.

Nga Ministria kompetente ishte dorëzuar përgjigje se personi zyrtarë -----ishte e punësuar në këtë institucion me sistematizim me Marrëveshje pa shpallje publike nga ISHP Shtëpia e shëndetit ----- në vendin epunës këshilltar për -----në njësinë e -----të llogaritur prej datës 17.07.2012.

Nëpërmjet një procedure për avancim me shpallje të mbrendshëme nr. 05/2018 të datës 26.09.2018 e njëjta ishte avancuar në vendin e punës idhëheqës i ----- Inspektor i lartë -----të llogaritur prej datës 26.09.2018.

Nga ana tjetër, personi zyrtarë----- ishte gjithashtu anëtar i Komisionit të -----, por me Aktvendim për emërim dhe plotësim të aktvendimit për formimin e komisionit për ----- Nr. 14-1242/1 i 05.02.2021, nuk është më anëtar i këtij komisioni.

Në seancën e mbajtur më datë 29.07.2022, pas shqirtimit të të gjitha pretendimebe, KSHPK-ja duke u nisur nga dispozitat e ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave të ndërpritet procedura për përcaktimin e konfliktit të interesave kundër personit zyrtarë -----udhëheqës në -----inspektor i lartë në -----e punësuar në Ministrinë e -----.

Respektivisht, pretendimet nga denoncimet vërtetohen, por personi i theksuar nuk është më anëtarë i komisionit për -----, pas së cilës u bë ndryshim të gjendjes faktike dhe KSHPK-ja ku ka më elemente për veprim të mëtutjeshëm.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Nënkryetar,
Nuri Bajrami

Pas përfundimit të seancës së KSHPK-së
Përgatiti: K.Z., Udhëheqës
Miratoi: Mr.VG, anëtar i KSHPK-së

